

## KLARA KODRA

## ZEF SEREMBEJA DHE FOLKLORI

Marrëdhënjet e poezisë së Serembes me folklorin, marrëdhënje që shtrihen pothuajse gjatë tërë zhvillimit të kësaj poezie, përbëjnë një problem interesant, i cili deri më sot nuk është bërë objekt i një punimi të veçantë.

Një meritë e padyshimtë e shkencës sonë të re letrare është vënja në dukje e ndikimit të poetit nga krijimtaria popullore.<sup>1</sup>

Veçse ky ndikim është parë kryesisht në aspektin formal duke shpjeguar me të, bie fjala, figuracionin e pasur që e dallon poezinë e Serembes.<sup>2</sup>

Janë bërë edhe përpjekje për një kuptim më të thellë të ndikimit të Serembes nga poezia popullore, përpjekje për ta parë këtë ndikim jo vetëm në formë, po edhe në frymë, po këto përpjekje nuk kanë shkuar përtej konstatimit.<sup>3</sup>

Studimi ynë ka për qëllim t'i hyjë më thellë këtij problemi, pa pretenduar ta shterojë atë, dhe të përcaktojë kriteret nga të cilat u nis poeti duke u mbështetur në folklor, shkallën e ndikimit nga folklori në krijimtarinë e tij si edhe fazat e ndryshme nëpër të cilat kalon ky ndikim.

Përpara se të ndalemi me hollësi mbi mbështetjen e Serembes në poezinë popullore duhet të themi para së gjithash se mbështetja në folklor, në kohën që krijoi Serembeja, nuk ishte një novacion në letërsinë arbëreshe. Përkundrazi, poezia popullore si limfë jetëdhënëse kishte qarkulluar gjithnjë në rrënjët e asaj letërsie që kur ajo lëshoi filizat e para me Filjen, Ketën, Varibobën e deri në lulëzimin e saj të plotë. Vjershat fetare të Brankatit e të Filjes në shekullin XVIII janë aq të afërta me këngët e popullit, sa pothuajse shkrihen me to. Kurse Variboba, i vetmi poet në kuptimin e vërtetë të fjalës që dha ky shekull, është, me gjithë ndikimin nga letërsia italiane që vihet re në veprën e tij, aq afër folklorit sa pjesa më e madhe e krijimeve të tij u

1) *Historia e letërsisë shqipe*, v. 2, Tiranë 1959, f. 193; Dh. Shuteriqi, *Mbi jetën dhe krijimtarinë e Zef Serembes*, «Buletini i Universitetit Shtetëror», 1961, Nr. 4, f. 37.

2) Në tekstin e *Historisë së letërsisë shqipe*, v. 2, Tiranë 1959, duke folur për këtë figuracion thuhet se «gurrë e gjithë kësaj pasurie artistike kanë qenë kryesisht gjuha dhe poezia popullore».

3) Në artikullin e Dh. Shuteriqit flitet për një ndikim nga poezia popullore «për nga forma dhe fryma» të krijimeve të hershme të Serembes, po nuk përcaktohet konkretisht se ku qëndron ky ndikim.

përhap në popull. Mund të thuhet se letërsia arbëreshe, duke e pasur folklorin jo vetëm burim të gjallë krijimtarie, po edhe mbrojtje kundër ndikimeve të huaja gjatë tërë rrugës që përshkoi nuk i shkëputi kontaktet me të. Marrëdhënjet e saj me poezinë popullore ishin marrëdhënie ndikimi reciprok. Kështu, në qoftë se shkrimtarët arbëreshë u ndikuan nga poezia popullore, më vonë një pjesë e madhe e krijimeve të tyre u bënë pronë e popullit. Kjo ndodhte jo vetëm në shekullin XVIII, kur nuk ishte bërë një ndarje e prerë midis letërsisë reflektive e folklorit, po edhe më vonë. Siç e provon dorëshkrimi i M. Belushit<sup>4</sup>, i cili nuk duhet të jetë aq i vjetër sa pretendohet, shumë pjesë të «Këngëve të Milosaos» hynë në poezinë popullore. Një fat të njëjtë kanë pasur vjershat e Serembes të cilat kanë qarkulluar gojë më gojë si poezi popullore.

Në shekullin XIX ndikimi nga folklori në letërsinë arbëreshe u bë më i ndërgjegjshëm duke fituar tipare të reja, gjë që u kushtëzua nga karakteri romantiko-patriotik që mori kjo letërsi. Shkrimtarët arbëreshë shihnin te folklori kryesisht frymën patriotike të tij si edhe tiparet specifike kombëtare. Ata u bazuan te poezia popullore kryesisht për të rikrijuar «motin e madh», shekullin e lavdishëm të Skënderbeut.

Shfrytëzimi i traditës popullore në romantizmin arbëreshë që thellësisht krijues, larg atij imitimi formal të poezisë së popullit në të cilin kishin rënë shumë poetë romantikë.

Një shembull i ndritur i këtij shfrytëzimi krijues që vepra e De Radës.

Mbështetja e Serembes në poezinë popullore hynte kështu në një traditë të përgjithshme, duke ruajtur njëkohësisht origjinalitetin e vet.

Në fillim të krijimtarisë së tij interesi i poetit për folklorin kishte karakter spontan, nuk rridhte prej një sistemi pikëpamjesh të përcaktuara po ishte kushtëzuar nga vetë ambienti në të cilin ai u rrit, nga ai ambient ku këngët ishin bërë pjesë e pandarë e jetës duke mos qenë vetëm relike të çmueshme të atdheut të largët, po në radhë të parë shfaqje aktive të shpirtit të kombit.

San Kozmo Albaneze ose Strigari, si e quajnë vendasit, fshati i poetit, shquhet për ruajtjen besnike të gjuhës dhe të zakoneve shqiptare. Strigari është një nga fshatrat arbëreshe që ruajnë krentimin karakteristik të fitoreve të Skënderbeut mbi turqit, çdo vit në pranverë, me këngë e valle.<sup>5</sup>

I lindur dhe i rritur në një ambient të tillë, Serembeja i kishte, si të thuash, në gjak këngët popullore më parë se t'u kushtonte një vëmendje të vetëdijshme.

Siç e kanë vënë re studjues të ndryshëm të Serembes të kohës para dhe pas çlirimit, shqiptarë dhe të huaj, Serembeja u afrohet poetëve popullorë edhe në mënyrën e krijimit. Mund të kujtonim përkufizimin e njohur të Stratikoit se «Serembeja ka qenë si zogu që këndon duke fluturuar dhe... nuk lë pas vetes veçse jehonën e ëmbël të melodive të tij të këndshme»<sup>6</sup>.

Që në femini poetit i zhvillohet aftësia për të improvizuar, aq e përhapur në këto vende. Krijimi i parë që i njohim «Kangjeelja e maalit të

4) G. Ferrari, *Canti albanesi. Raccolta di Michele Bellusci del '600*. Bari.

5) K. Kamsi, *San Cosmo Albanese (Strigari)*, Rev. «Leka», Nr. 1-12, 1939.

6) A. Straticò, *Manuale di letteratura albanese*, Milano 1896, f. 256.

paarë» improvizohet prej tij në moshën katërbëdhjetëvjeçare dhe është i ngjashëm me këngët popullore.

Aftësinë e improvizimit poeti do ta ruajë gjatë gjithë jetës dhe shpeshherë do t'i improvizojë dhe recitojë krijimet e tij si një këngëtar popullor. Kjo mënyrë krijimi që do ta karakterizojë gjatë gjithë jetës bëhet edhe shkak që shumë nga vjershat e tij të humbasin, meqenëse ai nuk kujdeset për t'i shkruar.

Më vonë miqësia me De Radën, Dora d'Istria, Kamardën dhe afrimi me lëvizjen patriotike do t'ja shtonin Serembes dashurinë për krijimtarinë e popullit duke i dhënë një karakter më të ndërgjegjshëm shfrytëzimit të kësaj krijimtarie nga ana e tij.

Përveç folklorit të gjallë me të cilin pati mundësinë or' e çast të binte në kontakt në jetë, qoftë në fshatin e vet, qoftë në fshatrat e tjera arbëreshe që vizitoi gjatë udhëtimeve të tij të shpeshta, poeti pati rast të njohë edhe folklorin e shkruar. Ishte koha e lulëzimit të veprave folkloristike. Lëvizja kulturele arbëreshe ishte në kulmin e saj dhe interesi për folklorin, si për një thesar të madh artistik të popullit shqiptar, sa vinte e po shtohej.

Që në vitet 1856-57 kishin dalë studimet e Biondellit<sup>7</sup> dhe të Vigos<sup>8</sup> ku i kushtohej vëmendje edhe folklorit shqiptar.

Më 1866 dilin «Rapsoditë e një poeme arbëreshe»<sup>9</sup> dhe Dora d'Istria botonte artikullin e vet të mirënjohur «La nationalité albanaise d'après les chants populaires»<sup>10</sup> që u përkthye edhe italisht dhe pati një përhapje të gjerë ndër arbëreshët.

Dy vjet më vonë dilnin «Shtojca e sprovës së gramatologjisë së krahasuar»<sup>11</sup> e Kamardës dhe vepra e Pitresë mbi këngët popullore siqeliane.<sup>12</sup> Më 1871 Jubani botonte veprën e vet «Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare»<sup>13</sup>.

Pas shtatë vjetve Mitkua botonte «Bletën shqiptare». Dhe duke marrë parasysh vrullin me të cilin u hodh Serembeja në lëvizjen kombëtare, etjen e tij për të ditur çdo gjë rreth letërsisë shqipe që po lindte, duhet besuar se ai ka njohur pjesën më të madhe të këtyre veprave.

Disa elementë të folklorit të Shqipërisë në poezinë e tij mbi të cilat do të kemi rast të ndalemi më poshtë, na japin shkas të mendojmë se ai mund të ketë njohur veprat e Mitkos dhe të Jubanit.

Po të analizojmë lidhjet e krijimtarisë së Serembes me poezinë popullore duke i krahasuar me lidhjet që kanë me këtë poezi vepra e De Radës dhe ajo e Darës mund të lindë përshtypja sikur mbështetja në folklor është më e thellë te këta të fundit. Po a i përgjigjet kjo përshtypje realitetit? Ndikimi i folklorit te De Rada e Dara, në të vërtetë është më i dukshëm. Vetë detyra që i vunë vetes dy bashkëkohësit e shquar të Serembes — rikrijimi i një shekulli të lavdishëm që jetonte në këngën e

7) B. Biondelli, *Studi linguistici-Colonie albanesi — Della letteratura popolare dell' Epiro*, Milano 1856.

8) L. Vigo, *Canti popolari siciliani*, Catania 1857.

9) De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze 1866.

10) Dora d'Istria, *La nationalité albanaise d'après les chants populaires*, «Revue de deux Mondes», Paris 1866.

11) A. Camarda, *Appendice al saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Prato 1866.

12) G. Pitré, *Sui canti popolari siciliani*, Palermo 1868.

13) G. Jubani, *Raccolta di canti popolari e rapsodie albanesi tradotti nell' idioma italiano*, Trieste 1871.

popullit — bëri që në veprat e tyre të depërtonte thellë folklori arbëresh me vetë konceptimin në proporcione vigane e trajta legjendare të herojve, me filozofinë që ata bartin në vetvete dhe përveç kësaj me motive, me veshjet figurative, me emrat e heronjve, me vargje të tëra. Gjithashtu si De Rada dhe Dara ruajtën trajtën metrike karakteristike të këngëve epiko-legjendare arbëreshe, gjë që u dha veprave të tyre ngjyrën pak arkaike.

Karakterit kryesisht lirik dhe tingulli më aktual i poezisë së Serembes e shpynë atë të kërkonte forma të tjera shfrytëzimi të traditës popullore.

Edhe burimet tek të cilët u mbështetën De Rada e Dara nga njëra anë dhe Serembeja nga ana tjetër qenë të ndryshëm: të parët u frymëzuan nga këngët liriko-epike arbëreshe të shekullit XV kurse Serembeja u mbështet më tepër në këngët lirike monostrofike të arbëreshëve të Kalabrisë.

Por mendojmë se mbështetja e Serembes në folklor ishte, edhe në qoftë se jo aq e dukshme se sa te dy autorët e tjerë të përmendur, po aq e thellë sa tek ata. Serembeja si De Rada e Dara mori nga poezia popullore jo vetëm atë formë të thjeshtë, të pasur, të gjallë, po mënyrën e perceptimit të realitetit. Kjo është më e ndjeshme në lirikën erotike, po ndihet deri diku edhe në lirikën patriotike.

Ndikimi i Serembes nga folklori vazhdon pothuajse gjatë gjithë veprimtarisë së tij letrare. Ai është më i thellë veçanërisht në periudhën që shkon nga viti 1857, datë e krijimit të parë të tij të njohur e deri në vitet 70 kur fillon një largim i ngadalshëm i tij nga poezia popullore, i kushtëzuar nga kriza e mistiçizmit dhe rënja që pësoi poeti në krijimtarinë artistike në atë kohë.

Në periudhën e parë që përmendëm, me gjithë vështirësitë që takojmë për shkak të mungesës së të dhënave të sakta lidhur me kronologjinë e vjershave të Serembes<sup>14</sup>, mund të dallojmë dy faza.

Në fazën e parë (1857-1860) poeti ndjek më tepër kriteret formale të mbështetjes në folklor duke shfrytëzuar motivet, situatat, figuracionin dhe metrikën e poezisë popullore arbëreshe. Shumë vjersha të tij të kësaj periudhe ngjajnë si një zhvillim i poezisë popullore («Kangjeelja e maalit të paarë», «Maali», «Për lyriën e Venetiës», «Kukëzës»). Megjithatë në to ndihet individualiteti krijues i poetit dhe ekziston një përputhje e plotë midis brendisë dhe formës popullore, kështu që nuk mund të bëhet fjalë për folklorizëm, për imitim të folklorit.

Mendojmë se në këtë kohë ndikimi i poetit nga folklori është krejt spontan.

Në mënyrë të vetvetishme ai i sheh fenomenet si një këngëtar popullor dhe ky vështrim i realitetit nga pikëpamja e popullit në mënyrë po aq të vetvetishme derdhet në forma popullore.

Më vonë (1860-1870) ndikimi i Serembes nga folklori nuk është aq i dukshëm: motivet, situatat, idetë bëhen më të ndërlikuara; nga vargjet dhe strofat e poezisë popullore poeti kalon në vargjet dhe strofat e poezisë reflekse, madje në forma të vështira si soneti; figuracioni merret ende nga burimi i pasur i poezisë popullore, por përpunohet

14) Për kronologjinë e vjershave të Serembes janë shfrytëzuar të dhënat që jep i nipi i poetit dhe vetë poeti në botimin e 1883-së; si edhe artikulli i Dh. Shuteriqit, *Mbi jetën dhe krijimtarinë e Zef Serembes*, «Buletin i USHT.» 1961, nr. 4.

me më tepër origjinalitet; poeti përdor më pak figurat tradicionale të folklorit dhe sajton vetë figura sipas modelit popullor.

Në vitet 70 si pasojë e rënjes që vihet re në krijimtarinë e Serembes, rënje e përcaktuar nga faktorë shoqërorë dhe psikologjikë (diziluzioni pas bashkimit të Italisë, disfatat në jetën personale) fillon një shuarje e ngadalshme e frymës popullore në krijimtarinë e Serembes.

Edhe në se te vjershat e tij të kësaj periudhe ruhet figuracioni i poezisë popullore dhe takohen herë pas here reminishenca formale të kësaj poezie ai nuk e sheh më realitetin nga këndi i vështrimit të poezisë popullore.

Filozofia e popullit, konceptimi i tij i jetës qëndron në bazë të lirikës erotike të Serembes.

Poeti ka thithur nga poezia popullore konceptin e shëndoshë të popullit për dashurinë që është i pandarë nga koncepti i besnikërisë:

Rrimi bashkë ndë djalërië,  
rrimi bashkë ndë pjakërië<sup>15</sup>

(Kangjeelja e Maalit të paarë)

T'e shkoonjë gjeelën me tyna u dëshiroonjë

(Më së bukurës ç'ë Stryhaarë)

Ashtu si në këngët popullore ndjenja e dashurisë shkon krahas me optimizmin. Dashuria quhet si burim gëzimi e qëndrese ndaj vështirësive të jetës:

Po këjo zemër u gëzuua  
kuër një vashëzë u buthtuua

(Kangjeelja e Maalit të paarë)

Të zenur dora-dora  
gjith heljmet na larhoomi

(Kangjeelje gazuloore)

Ai optimizëm, ajo forcë morale që e dallon këngën popullore ku asnjëherë nuk mohohet jeta edhe kur pohohet se dhimbja e dashurisë fatkeqe nuk do të shuhet kurrë — ndrit edhe në vargjet ku poeti vajton për humbjen e vashës, duke i shpëtuar nga psikologjizmi i sëmurë dhe kulti i dhimbjes.

Ideja e qëndresës, e triumfit mbi brengën që përshkon vargjet e fundit të vjershës «Kuljtim»:

Gjith muuari fundë! E mori vashëzë sot  
Ndërroom ty vetëheen e bëmë të thiel  
Larhoom baltjen ku hyra për tsa mot

.....

Kështu për tyna miirë uudhën e shkoonjë  
E gjith kështu tristimet prapa i ljë

të kujton një këngë erotike popullore arbëreshe:

Nani gjith u fërnuaa! Një helm i theel  
te zemra na kjëndron për mot e mot  
na besen kem të mbanjmi...  
u ngit harronj e ti mos më harro<sup>16</sup>.

15) Të gjitha citatet nga poezia e Serembes janë marrë nga botimi *Vjershe*, Milano 1926.

16) A. Scura, *Gli albanesi in Italia e i loro canti tradizionali* New York, 1912, f. 340.

Lidhur me këtë ide mund të kujtonim edhe vargjet e një rapsodie popullore arbëreshe që De Rada do të shfrytëzonte për «Milosaon»:

Duro, zemër e duro  
si duroi mali me borë<sup>17</sup>

Vetë figura e vashës në poezinë erotike të Serembes është e ngjashme në tiparet e saj kryesore me vashën e folklorit. Kjo vjen nga që ideali i gruas për Seremben është i afërt me atë të poezisë popullore. Vasha e dashuruar është e bukur, e shëndetshme, punëtore, e shkathët, gazmore:

E bardha vashëza ime e bukur ë:  
E prerë, e hoolë si kumbul shtuara rrië:  
Nd'etsen vete si zoogë e thomse më  
E ngenë zanin pjot me joonësië  
(Fytÿrja e asana)

Vinnej tue ndiel një ros  
E thyrnej: Ros ku jee?  
I thash u me haree:  
«Të faljem, bukurië!»  
Kjeshi e vate...

(Kangjeelje gazuloore)

Në këtë drejtim në poezinë erotike të Serembes vihet re një afërsi me lirikat erotike që do të shkruajë më vonë Çajupi. Vecse Serembeja në vizatimin e portretit të vashës shkrin ngjyrat e poezisë popullore me ngjyrat e poezisë romantike. Kjo bën që përshkrimi konkret dhe i gjallë të shkojë krahas idealizimit. Në fakt Serembeja zgjedh gjithnjë nga modeli popullor shka përputhet me konceptin e tij romantik të dashurisë dhe këtu qëndron ndryshimi kryesor midis poezisë së tij erotike dhe poezisë së Çajupit ku ndjenja e dashurisë është më konkrete, tokësore, reale dhe pasqyrohet në tërë dialektikën e saj të ndërlikuar. Te Serembeja kemi një alternim të pasqyrimin konkret të ndjenjës me hyjnizimin e kësaj ndjenje.

Edhe heroi lirik i poezisë erotike të Serembes në tiparet e tij të përgjithshme i përgjigjet trimit të poezisë popullore: një djalë që dashuron me sinqeritet e forcë, që edhe pse vuan nuk pendohet për ndjenjën e vet, i lidhur ngushtë me natyrën të cilën e bën sfond për bukurinë e vashës së dashuruar:

Kuër Agooja është e vjen prej deetit Jonë  
E fakja jote kundreeljtas i buthtoohet  
Gjith ljuljat që kaa bënur Ynë Zonë  
Zbeeten e dheu shkëljkjen edhe gëzoohet

(Gjën Kalini)

Po ndonëse figurat qendrore të lirikës erotike të Serembes kanë ngjashmëri me heronjtë e folklorit, ato kanë edhe tiparet e tyre individuale. Origjinaliteti i Serembes në këtë pikë bie në sy po ta krahasojmë me një poet tjetër arbëresh që u frymëzua edhe ai prej këngëve lirike erotike të arbëreshëve të Kalabrisë, me Santorin. Edhe në vjershat lirike të këtij poeti mund të gjendet koncepti popullor i dashurisë, tiparet e vashës dhe të trimit karakteristike për folklorin, figuracioni popullor.

17) De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze 1866, f. 22

Por heronjtë e lirikave të Santorit mbeten të saposkicuar si në poezinë popullore. Vasha e përshkruar nga Santori në vjershat e tij erotike nuk ka tipare të veçanta që ta dallojnë nga vasha e folklorit. Ajo përshkruhet me ngjyrat tradicionale të poezisë popullore:

Koilorm si trëntafilje  
Gazulloore.  
Ballin thieß e kurmin kish  
Bardhë si bora e tash vinxhoi  
Kjumshtin ëmbelje, më se t'ish  
I përzjerë me gjak.<sup>18</sup>

Ndërsa Serembeja edhe duke i kënduar bukurisë së vashës në frymë popullore di të nxjerrë në dukje ndonjë detaj të veçantë që ta individualizojë:

Shtekëljisur e bukur rrethas vë  
këshetin që shkëlqkjen vo mbë të zië

.....  
Të zes e me noer e maal të theelë  
syët e saaj...

Heroi lirik ka në vetvete përveç tipareve të trimit të poezisë popullore edhe tiparet e heroit romantik.

Ky hero vihet shpesh në situata të tilla që kanë analogji me ato të këngëve popullore. Kështu kur përshkruhet ndarja me vashën, qëndrimi i poetit është i ngjashëm me atë të këngëtarit popullor që shpreh pikëllimin e largimit, i lutet vashës që ta kujtojë ose ankohet për mospërfilljen e saj (Maali). Kur shprehet malli për vashën, i trimit që shkon në luftë te «Më së bukurës ç'ë Stryhaarë» vargjet e poetit (Vaajta te ljuufta e foortë... E shumë heerë si i bjeerrë ndë gjithësië / Më vinin trutë te tyë me dashurië) të kujtojnë për nga fryma një këngë popullore arbëreshe:

Mizore, kur të marrë malli për mua  
ti dil te kozarakji tuke thirr  
se u i ziu të përgjigjem n'atë guerr<sup>19</sup>

Një vend të veçantë në lirikën erotike të Serembes e zë kontrasti midis shqetësimit të vazhdueshëm të trimit dhe gazit të shkujdesur të vashës, kontrast karakteristik për poezinë popullore arbëreshe.

Vargjet e poetit:

Ndë pakj, o vash, ty rrië; u rrië nd' angime  
T'ÿ rrië ndë gaze edhe u ndë shërëtime<sup>20</sup>

(Ngolaat)

të kujtojnë vargjet popullore:

Ti rri te shtrati e u te kjo laviin  
Ti ben të bukrin gjuum, u bier shëndeen<sup>21</sup>

18) G. Santori, *Il prigioniero politico*, Cosenza 1850.

19) A. Scura, *Gli albanesi in Italia e i loro canti tradizionali*, New York 1912, f. 328.

20) Në revistën «Arbri i rri», Palermo 31 mars 1887 këto vargje janë:

Ti rri ndë ghaze, u ndë shërëtime  
ti rri nd' orekse, u ndë rëkime.

21) A. Scura, *Gli albanesi in Italia e i loro canti tradizionali*, New York 1912, f. 316.

Në poezinë erotike popullore të arbëreshëve të Kalabrisë një rol të veçantë luan konflikti i dashurisë së të rinjve me ambientin plot thashetheme të fshatit. Këngëtari popullor zakonisht mban qëndrim të vendosur protestues kundër këtij ambienti:

E gjindja jet e thon e si të don,  
se ti e ke lisin që hjen t'e mban,  
se ret përpara diellit ven e ven  
se bora zëmrat tona nëng i ndan.  
Mos vër re ndë kekj na duan e fjasën,  
u, vash, tij nëng të ljë e munt më vrasën  
te dera jote kriet munt m'e presën<sup>22</sup>

Ky konflikt ka gjetur shprehje edhe në poezinë erotike të Serembes me një notë të veçantë që i vjen nga mbështetja në jetën e poetit:

E gjindja më pjakosen me këshyla

(Kë në kë maali)

Për maalin na të dyë sa shkkuam laviina  
Sa gjëmbe shkkuamë!

(Ngolaat)

Fryma e poezisë popullore ka depërtuar, ndonëse më pak, edhe në poezinë patriotike të Serembes. Në vjershën e tij të hershme «Për lyriën e Venetiës» Garibaldi dhe trimat e tij konceptohen në trajtat e hiperbolizuara të heronjve të folklorit:

Këmishkukji trim me fjet  
.....

kur rrebtas shpaten nxjerr  
si rrufeeja dieg e shkier  
.....

Kjeeli veshet njoo me tym  
bën buhooj një mjeegulim.  
E për gjëmben tundet dieli  
E trandaksen edhe kjeeli

Në satirën e mprehtë të vargjeve të para ndihet forca e humorit popullor:

Ndçiku duuali e vate  
sa po i dhaanë dyë buuzikate

Serembeja ka shfrytëzuar disa motive të poezisë popullore arbëreshe. Kështu ai prek motivin e triumfit të dashurisë mbi vdekjen, motiv të cilit Dara do t'i jepte më vonë shtjellim në poemën e tij. Këngëtari popullor thotë për këtë:

Ma ende kurmi te varri më shihet  
zën tënte gjegjur ka vëdekia ngrehet<sup>23</sup>

dhe poeti:

22) A. Scura *Gli Albanesi in Italia e i loro canti tradizionali*, New York, 1912, f. 318, 336.

23) Fjamuri i Arbërit v. III, Nr. 2.

Kuër era vrundulisen si një heerë  
 Fjaaljat që për muua dërgon vo maali  
 Më vjen te varri si një paaraveerë  
 Më duket varri i ëmbelj posi zaali.

(Kënekë maali)

Një motiv tjetër i poezisë popullore që Serembeja shfrytëzon duke derdhur në të frymën e kohës është ndarja me të dashurën e trimit që shkon në luftë. Një këngë me subjekt të tillë pat mbledhur De Rada te «Rapsoditë e një poeme arbëreshe.»

Në këngën popullore ekziston një konflikt midis vajzës, e cila e kundërshton largimin e të dashurit dhe djalit që është i vendosur të shkojë në luftë:

Lusi vasha tënë zonë  
 të bijin tri pika shi  
 trimi t'mos vei ndë guerret.  
 — Ndo lusen, ndo mos ti vash,  
 pra që gjë më se m'mbanë  
 mos sot, nesërith  
 u ndë guerrë vetie <sup>25</sup>.

Nota mbizotëruese në këngë është dëshpërimi i saj. Një trajtim i afërt i këtij motivi gjendet në «vjershën» e Rinës para largimit të Milo-saos në poemën e De Radës. Tek Serembeja motivi në fjalë ka pësuar evolucion: në plan të parë këtu qëndron ndjenja patriotike. Edhe në goftë se vasha e ndjen thellë hidhërimin e ndarjes siç del nga vargu:

Ty kjaanë? Nani mos kjaaj

ajo është kryesisht «zoonjëzë arbënoore» që e pati pritur me një buzë-qeshje krenare vendimin e të dashurit për të vajtur atje ku «vatra... thyrrret». Kështu që, ndryshe nga ç'ndodh në këngën popullore, karakteri kushtrues është ai që i jep tonin vjershës.

Nga folklori kjo vjershë ka marrë edhe karakterin deri diku abstrakt konvencional.

Një motiv popullor që poeti ka ditur ta lidhë me rrethanat e jetës së vet qëndron në bazë të vjershës «Kukëzës» vargjet e së cilës ndrijnë nga optimizmi, humori i këndshëm i popullit:

Duke bërë: kuku kuku  
 thuuj saa vjet kam rroonj po u.  
 «Kuku!» Një? A kuke e shkret  
 pjasçë! Se u rroonjë për vjet e vjet  
 .....

Kam martoonjë ndë më shkoft kreeut  
 u të Bukurën e Dheeut?  
 Ose Pjakës dhëmbëzëzë  
 unë i mjeerë kam t'i vë kezë?  
 Kukza e urtë së u përgjegj  
 Do të theet: Tÿ rron si rregj!

24) Në botimin italisht të 1883-së, dy vargjet e fundit janë:

Io allora balzerò dal luogo dove sono disteso  
 e pel gaudio darò un sospiro e un lamento

Siç shihet, në këtë variant Serembeja qëndron më pranë këngës popullore. Më vonë i jep idesë një theks më romantik.

25) G. De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze 1866, f. 25.

Vargjet aq shprehëse që e mbyllin vjershën «Zoonjës Ljuulje»:

e treten dalj nga dalj posi lumakjë  
bukuritë që te bënë si paraveera

janë një zhvillim i motivit të përkohësisë së bukurisë që gjendet edhe në folklorin arbëresh:

E ljosen bukuritë  
Si bor kur vera e çon<sup>26</sup>

Një motiv tjetër të afërt — motivin e shkurtësisë së jetës që ndeshet në folklorin arbëresh e gjejmë në poezinë e Serembes të shprehur po në atë formë që ka zgjedhur për të këngëtori popullor. Krahaso:

Pastaj shuhet ky lihnaar<sup>27</sup>

me vargun

E pak nga pak shuhet kyë lynaarë

(Kuljtim)

Mbështetja në folklor mund të shpjegojë disa tipare të stilit të Serembes siç janë spontaneiteti i pakrahasueshëm, sinqeriteti gati naiv që i jep forcë komunikuese. Mjaftor të citojmë disa vargje nga «Kangjeelja e maalit të paarë», ku gurgullon ndjenja në mënyrë të vetvetishme, pa asnjë letrarizëm:

Kuër e ruuata, kuër e pashë  
«Saa e bukur!» mbjat u thashë.  
Çë atë heer së pat pushim  
Kyë i mjeeri shpirti im.

Poeti ka asimiluar figuracionin e pasur dhe të shumëllojshëm të poezisë popullore. Është fjala jo vetëm për figurat e gatshme, tradicionale të kësaj poezie që, megjithëse nga përdorimi i gjatë kanë një vlerë të figurshme relative, janë më të freskëta se figurat e letërsisë reflektive, po edhe për figura origjinale të krijuara sipas modelit të poezisë popullore duke marrë për bazë fenomene të njohura e të thjeshta nga jeta.

Kështu në poezinë erotike të Serembes takohen dendur epitetet dhe krahasimet e zakonshme për poezinë popullore si «buzëkuralje», «mes-hollë», «si bora n' ato malje», «si trëndafylje», «posi mollë» dhe metafora klasike e poezisë erotike arbëreshe të Kalabrisë «ljuulje».

Mund të kujtojmë hiperbolën e goditur për të përshkruar bukurinë e vashës:

Kuër te sheshi ajo vo shkontej  
i tërë sheshi dritësontej

që të sjell ndër mënd vargjet e folklorit arbëresh:

26) G. Ferrari, *Rapsodie e scene di vita degli albanesi di Calabria*, Cosenza 1959, f. 70.

27) Po aty.

Jini di motra që diellit i gjini  
Kurna më dilni udhën dritsooni<sup>28</sup>.

Figura plot hijeshi që mbyll vjershën «Kangjeelje gazuloore» të kuj-

Hera erdhi të martesës,  
Diel Zoti na bekon.  
Edhe dritën që shtelon  
Shkjepë bënët, tsoohë e keezë

të kujton «Rapsoditë» e mbledhura nga De Rada;

kam për sqep kjiellin me iliz,  
keza ime dielli,  
kam për coghë deitin<sup>29</sup>

..... për cilonë dritien  
rrethin e kjiellit për brez,  
spingullat që i vë te keza  
iliz marrë nqiellshit<sup>30</sup>

Me origjinë popullore janë edhe simbolet e përdorura në vjershat «Kênzoori e bylbyli» dhe «Vashes e laarhë». Në të parën që shpreh brengën e dashurisë së papërfillur paraqesin interes të veçantë simbolet e trëndafilut dhe të bilbilut karakteristike për poezinë orientale që nuk takohen në folklorin arbëresh dhe që Serembeja mund t'i ketë marrë përmes folklorit shqiptar.

Te e dyta bie në sy figura simbolike e diellit dhe e hënës që ndjekin më kot njëri-tjetrin, figurë që duhet të ketë burim popullor.

Duke u mbështetur në burimin popullor Serembeja krijon vetë figura origjinale si shprehjen metaforike «ka për nuse fjamurin» te «Dejtë-noori», që jep me aq forcë në frymë popullore idenë e besnikërisë ndaj çështjes kombëtare, krahasimet «si goozhdëzë aari që më vjeen ndë gjië», te «Më së bukures ç'ë Stryhaarë» që shpreh si bukurinë e vashës ashtu edhe dhimbjen e poetit dhe «si baari i djegur do të bjeerë» te «Gjën Kalini» që jep idenë e zhdukjes dhe në të njëjtën kohë e pasionit të zjarrtë.

Te «Eledçië», nën ndikimin e stilit popullor janë krijuar figura të tilla plot gjallëri:

E kjëndroova si trangu që rrië  
Te pylja për së kuntreelja  
Dieelit....  
Rroojta si guuri i ljuumit  
çë së ndikuron se kush e çaanë  
.....

Nj'ylë i bukur m'u buthtua.  
S'ish nj'ylë, po ish një vash.

(«Eledçië»)

Të kujtohen për këtë figurë të fundit paralelizmat negative karakteristike të rapsodive epiko-legjendare arbëreshe:

28) A. Scura, *Gli albanesi in Italia e i loro canti tradizionali*, New York 1912, f. 316.

29) De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze 1866, f. 70.

30) *Po aty*, f. 83.

dukej një kamnua i zi  
 po ai nk'ish kamnua i zi  
 se më ish trime i ri.<sup>31</sup>  
 Pe të bardhin një shërbes  
 të bardhë si një cop rëgjent  
 .....

Nk'ish po ajo cop rëgjent  
 se ish zonjë e arbëresh.<sup>32</sup>

Reminiscencë e këtyre rapsodive është metafora «shkjepi të vëdekëjes» që gjejmë në fund.

Te «Kuljtim» poeti për të shprehur dhimbjen e tij të thellë përdor me art të rrallë një simbol popullor. Vargjet:

E vaan njeera sot si nëndë vjet.  
 Nëndë heer paaraveera ljuljëzooj  
 E nëndë plahë u kam te zemra e shkret

bazohen në kuptimin e veçantë — kryesisht tragjik — që ka në poezinë popullore numri nëndë. Një kuptim i tillë simbolik ishte i përhapur në folklorin arbëresh siç dëshmon kënga e njohur e Garentinës:

Ish nj' emë shum' e mirë,  
 kishte nëntë bilj hadhiarë<sup>33</sup>

Ka mundësi edhe që poeti të ketë njohur rapsodinë tonë legjendare të veriut «Gjergj Elez Alia», meqenëse vargjet e Serembes të cituara më lart kanë një analogji shumë të ngushtë me vargun e dytë të kësaj rapsodie:

Nandë vjet nandë varra në shtat m'i ka<sup>34</sup>

Edhe trajtat metrike të përdorura nga poeti janë në shumë raste ato të folklorit veçanërisht në vjershat e hershme si «Kangjeelja e maalit të paarë», «Maali», «Kukëzës». Vargu i përdorur është distiku tetërokës i rimuar karakteristik për këngët erotike të arbëreshëve të Kalabrisë. Po ashtu edhe strofën tetëshe me skemë AABCCDD të përdorur te «Ngolaat» e gjejmë në folklorin arbëresh, veçse jo aq në vendlindjen e Serembes, po më tepër te arbëreshët e Siqelisë nga mund ta ketë marrë poeti.

Edhe në poezinë e Serembes takohen hyrjet e menjëhershme në temë karakteristike për poezinë popullore. Të kujtohen pyetjet retorike plot ankh e shqetësim që hapin vjershën «Kuljtim» duke krijuar një atmosferë:

Haadhjarezë vesh ku jee, kur rrië, ku bredh?  
 Ç'ëndren, çë pandehën, çë kërkon?  
 .....

E bukuriëza jote ku gëzon?

Duke lexuar këto vargje të vinë në mëndje vargjet e para të një kënge erotike arbëreshe me subjekt të afërt:

31) G. De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze, 1866, f. 28.

32) *Po aty*, f. 65.

33) G. De Rada, *Rapsodie di un poema albanese*, Firenze 1866, f. 29.

34) *Këngë popullore legjendare*, Tiranë 1955, f. 122

Engjëll, çë mi penson ti me ata truu?  
 Se m'u kjas moti çë ndërron ti shpi  
 E më ndërron ti shtratin ku ti fjë  
 E mi ndërron katund e gjitoni  
 E ku e kjell at bukuri çë ke?<sup>35</sup>

Shpesh gjejmë vargje pothuajse krejt të ngjashme me ato të poezisë popullore, si, bie fjala, te «Fati»:

Nga mali u vre dhe egëras gjëmoojti  
 që të kujton vargjet popullore:

M'u err ka mali e më zu trupia  
 M'u err ka mali e m'u nxi si pisa<sup>36</sup>.

Nga sa u tha më sipër për lidhjet e krijimtarisë së Serembes me poezinë popullore mund të nxirret përfundimi se mbështetja e tij në folklor nuk ishte një stilizim i ftohtë si ai në të cilin binin shpesh poetët romantikë evropianë, nuk reduktohej në anën formale, po ishte një mbështetje e thellë krijuese që lidhej me shumë veçori të stilit të tij.

Serembeja përvetësoi qëndrimin e popullit ndaj fenomeneve si edhe formën artistike të të shprehurit të mendimeve dhe kjo ishte për të e natyrshme se përshtypjet e para të pashlyeshme e drejtonin nga poezia popullore, pikërisht aty ku e drejtonte nga ana tjetër edhe tradita e letërsisë arbëreshe.

Folklori e ushqeu poetin me konceptet e shëndosha për jetën e dashurinë, me optimizëm, ja ndezi edhe më frymën patriotike e shoqërore. Nga burimi i gjallë i poezisë së popullit ai mori thjeshtësinë, freskinë, spontaneitetin që e dallojnë stilin e tij.

Mjaft motive të krijimtarisë popullore gjetën shtjellim në krijimtarinë e tij. Kështu ai shfrytëzoi motivin e ndarjes midis vashës e trimit, motivin e vajtjes së trimit në luftë, motivin e kundërshtimit të ambientit ndaj dashurisë së të rinjve, motivin e përkohësisë së bukurisë e të jetës etj.

Ndikimi i poetit nga folklori, si patëm rast të shihnim, u kufizua kryesisht në lirikën erotike. Serembeja u bazua më tepër në të ashtuquajturat «vjershe», këngët lirike monostrofike të arbëreshëve të Kalabrisë, që mori për model edhe De Rada për monologjet e bijës së Kologresë në «Këngët e Milosaos». Ndikohet, po më pak, edhe nga këngët epiko-lirike të shekullit XV.

Shumë nga lirikat e tij erotike duken si zhvillim i poezisë popullore. Edhe personazhet qendrore të tyre kanë ngjashmëri me heronjtë e folklorit, sidomos vasha tek e cila theksohen tiparet e bukurisë (në kuptimin që i jep populli dhe që lidhet me shëndetin e forcën), të thjeshtësisë, të shkathtësisë në punë; po edhe heroi lirik që të kujton trimin e poezisë popullore me ndjenjat dhe mendimet e veta për dashurinë dhe jetën. Veçse këto tipare të përgjithshme plotësohen me detaje konkrete që u japin heronjve individualitetin e vet.

Siç e pamë, poezia popullore ka ushtruar ndikim edhe në lirikën patriotike e shoqërore të Serembes. Veçse këtu ky ndikim nuk ka karakter aq të ndijshëm si në lirikën erotike.

<sup>35</sup>) A. Scura, *Gli albanesi in Italia e i loro canti tradizionali* — New York 1912, f. 338.

<sup>36</sup>) *Po aty*, f. 322, 320.

Në formë Serembeja përdori metrikën popullore në shumë nga vjer-shat e tij, mori nga krijimtaria e popullit atë thesar figurash të freskëta e shprehëse që veprojnë menjëherë mbi imagjinatën dhe zemrën e lexuesit. Së këndejmi mund ta ketë burimin edhe qartësia e forca komuni-kuese e krijimtarisë së Serembes.

Kjo mbështetje në formë e në frymë në traditën popullore ka bë-rë që lirika e Serembes me gjithë rrezatimet e letërsive të tjera të ketë rrënjët thellë në tokën tonë.

Ashtu si bashkëkohësit e tij De Rada e Dara po nëpërmjet forma-ve të tjera origjinale, Serembeja derdhi në veprën e vet shka pat thi-thur qysh fëmijë nga burimi i freskët, i poezisë popullore duke i dhënë si poet i vërtetë vulën e talentit të vet.

### R é s u m é

#### ZEF SEREMBE ET LE FOLKLORE

Dans l'article ci-contre est analysée l'influence de la poésie populaire dans l'oeuvre de Zef Serembe. L'auteur fait relever que cette influence a été exprimée en tout premier lieu dans le contenu, dans la façon de perception de la réalité et dans l'idée, ensuite dans la forme, les motifs, la riche représentation figurée et même, souvent, aussi dans la métrique.

L'influence de la création du poète du folklore fait état d'une certaine évolu-tion: on y discerne une première phase (1857-60) où cette influence est plutôt de forme, et une autre phase (1860-70) où cette influence devient plus créative. A une troisième phase, l'influence du folklore s'éteint presque complètement.

L'appui de Serembe sur la poésie populaire se rattachait à une tradition géné-rale de la littérature des Albanais d'Italie, mais elle n'en portait pas moins son ori-ginalité propre.